

QFB



NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

**RISE
E NOTERISE**

DHOMA

DEGA VENDORE TIRANË

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 10147

Nr. koleksioni: 4280

Tirane më 09/11/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar





Taksa e Pullës u Likuidua



KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, më 9 / 11 / 2023, përpara meje Noterit Julian Zhelegu, me seli në adresën Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13, K. I, Tiranë, Shqipëri, lidhet kjo Kontratë (në vijim "Kontrata"), nga dhe ndërmjet:



SHITESI:

Erald Dushku, atësia Arben, amësia Dëshira, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga.Ferit.Xhajko P.61/2 Sh.3 Ap.30; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 30/11/1977, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031849827 dhe nr. personal H71130024I;

(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si "Shitësi")

dhe

BLERESI:

"New opportunities" shpk, një shoqëri e themeluar e që ekziston sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NIPT L71507037J, me seli të regjistruar në Zone Kadastrale 2881, Pasuria 19741/2 , Rruga Nacionale "çameria", Shtepi Dykateshe Nr.7, Konispol, Sarande, përfaqësuar nga Administratori i vetëm **Shkëlqim Llagaçi**, atësia Ismail, amësia Sere, shtetas Shqiptar, lindur në Peshkopi, Dibër dhe banues në KAMËZ, me adresë Polican 03840385; Nd. 3; H. 1; Kamëz; Kamëz; 1030; Kamëz, lindur më 09/05/1976, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034323889 dhe nr. personal H60509092O;

(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar bashkërisht si "Blerësi")

Palët e mësipërme ne vijim dhe për efekt te kësaj Kontrate, do te referohen individualisht si "Pale/a" dhe se bashku si "Pale/et".

MEQENESE:

- Shitësi është ortak zotërues i 100 % (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "STRAT ADVISORS" Sh.P.K. (ne vijim "**Shoqëria**"), një shoqëri e themeluar e që ekziston sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NIPT L61517016N, me seli të regjistruar në Tirane, Njësia bashkiake Nr.5, Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kulla 1, Kati 6, Zyra A3, dhe ka një kapital themeltar prej njëqind mijë (100.000) Lekë dhe Shitësi është zotërues i 100% (njëqind përqind) te kapitalit të regjistruar te shoqërisë, sikurse rezulton nga Ekstrakti i Regjistrit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 100 % (njëqind përqind) të kapitalit te Shoqërisë (ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si "**Kuota**") dhe Bleresi dëshiron te blejë prej blerësit Kuoten.

KONTRATË SHITJE KUOTE

Faqja



A2023053950444066045

- C. Kalimi i Kuotes sipas kesaj Kontrate eshte miratuar me vendimin bashkelidhur te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise "STRAT ADVISORS" shpk si dhe me vendimin bashkelidhur te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Bleresit.
- D. Nga verifikimi i Regjistrimit te Barreve Siguese, Kuota rezulton te jete e barrësuar ne favor te Bankes CREDINS, e cila nëpërmjet deklaratës noteriale me nr. 10108 rep, nr. 4266 kol, datë 8 / 11 / 2023, bashkelidhur ka dhene pelqimin per kalimin e Kuotes.

PER SA ME SIPER, Palët ranë dakord për te lidhur këtë Kontrate Shitje Kuote.

NENI 1 OBJEKTI

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë së Kuotës nga Shitësi te Blerësi dhe fitimi i pronësisë mbi Kuotën qe përfaqëson 100% (njëqind përqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqërisë nga Blerësi, sipas kushteve dhe afateve te përcaktuara ne këtë Kontrate.
- 1.2. Me lidhjen e kesaj Kontrate pronësia mbi Kuoten kalon nga Shitesit te Bleresit ku blerësi fiton pronësinë mbi 100% (njëqind përqind) te kapitalit.

NENI 2 ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1. Çmimi i shitjes se Kuotës qe përfaqëson 100% (njëqind përqind) te kapitalit të Shoqërisë është LEK 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe eshte paguar tërësisht nga Blerësi ne favor te Shitesit me para ne dore dhe jashtë zyrës se noterisë përpara lidhjes se kesaj Kontrate.
- 2.2. Çmimi i shitjes gjendet i drejte dhe i arsyeshëm dhe Palët garantojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate nuk do te kenë asnjë pretendim ne lidhje me çmimin e shitjes dhe mënyrën e pagesës.

NENI 3 KALIMI I PRONESISE MBI KUOTEN

- 3.1. Pronësia mbi Kuotën qe përfaqëson 100% (njëqind përqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqërisë kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me lidhjen e kesaj Kontrate, e cila do te regjistrohet menjëherë në librat e Shoqërisë si dhe në Regjistrimin Tregtar sipas ligjit.
- 3.2. Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit te kapitalit te Shoqërisë, me lidhjen e kesaj Kontrate, do te jete si vijon:
- z. Erald Dushku largohet nga Shoqeria;
 - "New opportunities" shpk. bëhet ortak i vetem i Shoqerise, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit me vlere prej 100.000 leke.

NENI 4 DEKLARATA DHE GARANCI

KONTRATË SHITJE KUOTE

Faqja



A2023053950444066045

4.1. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:

- a. Shitësi është zotëruesi i vetëm i Kuotes se Shoqërisë dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Kuota dhe ka tagra te plota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij.
- b. Kuota është nënshkruar dhe paguar plotësisht.
- c. Kuota e zotëruar nga Shitësi është lirishit e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate. Shitësi ka të drejtë të shesë dhe t'ia transferojë Kuotën Blerësit sipas kësaj Kontrate. Blerësi fiton të drejtat e plota e të pakufizuara të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate.
- d. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
- e. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Shitësi garanton Blerësin se do t'i sigurojë atij kontrollin efektiv të Shoqërisë në përputhje me të drejtat që rezultojnë nga zotërimi i Kuotës.
- f. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a. Blerësi ka tagra te plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.
- c. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

4.3. Palët konfirmojnë se detyrimi i Blerësit për pagimin e çmimit të shitjes është përmbushur përpara lidhjes së Kontratës.

Neni 5

DISPOZITA TE FUNDIT

5.1. Kjo Kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

5.2. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzoleve apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

5.3. Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

KONTRATË SHITJE KUOTE

Faqja



A2023053950444066045

5.4. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.5. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontratës i bashkëlidhen kopje të dokumenteve të identifikimit dhe përfaqësimit të Palëve dhe Aneksi-A (Ekstraktet nga Regjistri Tregtar i Shoqërisë dhe Blerësit) dhe Aneksi B (Ekstrakt i Shoqërisë nga Regjistri i Barrëve Siguruese) dhe Aneksi C (Vendimi i Asamblesë së Ortakeve të Shoqërisë dhe Blerësit për miratimin e transferimit të Kuotës) dhe Aneksi D (Deklarata Noteriale e Bankes CREDINS).

Unë Noteri e hartova këtë Kontratë sipas kërkesës së Palëve në gjuhën Shqipe dhe në katër origjinalë e pasi ua lexova me zë të lartë e të qartë, u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur përpara meje, nënshkruhet prej tyre rregullisht në praninë time dhe unë e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë pasojat e tij.

SHITËSI
Erald Dushku
shpk.



BLERËSI
"New opportunities"

Administrator
Shkëlqim Llagaci

Shkëlqim Llagaci

NOTERI
Julian Zhelegu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 10109


Nr. koleksioni: 4266

Tirane më 08/11/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2023053950480171989



Taksa e Pullës u Likuidua



DEKLARATË NOTERIALE

Sot më datë 8-11-2023 para meje Julian Zhelegu, noter pranë Dhomës së Noterisë së TIRANË, u paraqitën personalisht:

Z. Ervin Boçi, lindur me 14.08.1989, me Leternjoftim Nr. Personal I90814110J, me cilesinë **Ass. Drejtor Dege per Kredine** prane "BANKA CREDINS" SH.A, Tirane, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003, regjistruar në organin tatimor me Kodin Fiskal Nr.3709529, NUIS Nr. K31608801O, si dhe me Licensën e Bankës së Shqipërisë Nr.16, datë 31.03.2003-----;

Z. Igli Hysenaj, lindur me 13.08.1983, me Leternjoftim Nr. Personal I30813173V, me cilesine **Analist Kredie**, prane "BANKA CREDINS" SH.A, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003, regjistruar në organin tatimor me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NUIS Nr. K31608801O, si dhe me Licensë nga Banka e Shqipërisë Nr. 16, datë 31.03.2003-----;

Të dy personat e mësipërm madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, të cilët deklaruan si më poshtë-----;

"Ne, të sipërmëshkruarit, në cilësinë e përfaqësuesve ligjorë të "BANKA CREDINS" SH.A me anë të kësaj deklarate, japim pëlqimin që z. Erald Dushku të kalojë në favor të shoqërisë tregtare New opportunities shpk me NUIS L71507037J me anë të shitblerjes pronësive të 100% të kuotave që zoteron në shoqëri tregtare STRAT ADVISORS shpk me NUIS L61517016N, me kusht që edhe pas ndryshimit të pronësive, kuotat të vazhdojnë të qëndrojnë të bllokuara duke mbartur të gjitha barret sigurorese që aktualisht rëndojnë mbi to në favor të shoqërisë "Banka Credins"Sh.a.-----;

Pas kalimit të pronësive të kuotave si me sipër cituar struktura e ortakëve të shoqërisë tregtare STRAT ADVISORS shpk do të ndryshojë dhe do të jetë si vijon:

Shoqëria tregtare New opportunities shpk do të zotërojë 100% të kapitalit të shoqërisë tregtare STRAT ADVISORS shpk.

Kjo deklarate në asnjë rast nuk përben dhe as nuk mund të interpretohet si deklarate lirimi dhe kuotat e kapitalit të shoqërisë tregtare STRAT ADVISORS shpk në pronësi të shoqërisë tregtare New opportunities shpk do të vazhdojnë të qëndrojnë të bllokuara në favor të Bankës Credins sh.a.

Sa më sipër, deklarojmë nën përgjegjësinë tonë personale-----;

Unë, noteri, pasi dëgjova deklaratimet e bëra nga deklaruesit dhe verifikova dokumentet përkatëse, konstatova se deklarata është në përputhje me vullnetin e lirë dhe të pavarur të



A2023053930480171989

deklaruesve dhe konform ligjit. Për këtë arsye, unë e nënshkruaj atë duke i dhënë forcën e nevojshme ligjore.-----;

DEKLARUES
"BANKA CREDINS" SH.A.

Z. Ervin Boçi
Ass. Drejtor Dege per Kredine

Ervin Boçi

Z. Igli Hysenaj
Analist Kredie

Igli Hysenaj

NOTER

Julian Zhelegu